



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim Letrar B-A**

Ngarkesa: 3 kredite: 10 orë leksionedhe20 orë seminare

Viti / Semestri: Viti II, semestri I

Lloji i lëndës:Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit:Master Shkencor në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i Universitetit të Tiranës (Nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJA DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

T'u ofrojë studentëve njohuri themelore mbi teoritë kryesore të përkthimit letrar dhe sfidat që ai paraqet.T'i aftësojë studentët të ruajnë ekuilibrin mes besnikërisë ndaj tekstit burimor dhe përshtatjes për audiencën e synuar.Të rrisë ndërgjegjësimin për rolin e përkthyesit si ndërmjetës kulturor dhe ruajtës i dialogut ndërkulturor.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të zhvillojë aftësinë e studentëve për të interpretuar dhe përkthyer me saktësi elementet stilistike si ironia, humori apo veçoritë gjuhësore të një autori.
- 2.T'u mësojë studentëve teknikat për ruajtjen e zërit dhe qëllimit të autorit në tekstin e përkthyer.
- 3.T'i ndihmojë studentët të kuptojnë dhe zbatojnë përgjegjësitë etike që lidhen me përkthimin letrar, përfshirë respektimin e të drejtave të autorit dhe integritetin e veprës.

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të kësaj lënde, studentët do të jenë të aftë:

- 1.Të analizojnë dhe zbatojnë parimet e besnikërisë dhe përshtatjes krijuese në përkthimin letrar.
- 2.Të zgjidhinproblemet që lindin gjatë procesit të përkthimit poetik.
- 3.Të veprojnë si ndërmjetës kulturorë, duke kapërcyer me sukses pengesat gjuhësore dhe kulturore.
- 4.Të ruajnë zërin dhe stilin origjinal të autorit në përkthimet e tyre.